

**VENDIM**  
**Nr. 491, datë 21.7.2022**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT, TË QENDRAVE SHËNDETËSORE NË BASHKINË KURBIN DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit të 5 (pesë) qendrave shëndetësore në Bashkinë Kurbin, në masën 261 909 200 (dyqind e gjashtëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntë mijë e dyqind) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimi i qendrës shëndetësore në fshatin Gjorëm, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, në masën 62 744 700 (gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimi i qendrës shëndetësore Sanxhak-Laç, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, në masën 31 004 500 (tridhjetë e një milionë e katër mijë e pesëqind) lekë pa TVSH;

c) Rindërtimi i qendrës shëndetësore në qytet Mamurras, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, në masën 76 407 700 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH;

ç) Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore në qytet Laç, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, në masën 72 729 200 (shtatëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind) lekë pa TVSH;

d) Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore në Fushë-Milot, Njësia Administrative Milot, Bashkia Kurbin, në masën 19 023 100 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëzet e tre mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në masën 52 381 840 (pesëdhjetë e dy milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

3. Çaktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**